



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 24.7.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Besa Gaxherri dhe Enver Hoti.

Munguan: Srđan Mitrović, Liburn Aliu, Salih Zyba, Danush Ademi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 10.7.2018;
3. Plani i punës së komisionit për vitin 2018;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.7. 2018**

**Kryetari i komisionit** konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.7. 2018, 3.7.2018 si dhe 26.6.2018.

**3. Të ndryshme**

**Kryetari Muharrem Nitaj** propozoi që të ndryshoi renditja e pikave të rendit të ditës ngase pika qendrore për planin e punës është temë interne e komisionit dhe diskutimet kryhen në fund të mbledhjes, ndërkaq për të ndryshme propozoi të konfirmohen këto nënpika :

- Pasi që komisionet e përhershme kanë proceduar rekomandimet e tyre për dy projektligje të këtij komisioni, Projektligjit për kompleksin “Adem Jashari” në Prekaz dhe PL për veprimtaritë hidrometeorologjike, Komisioni konfirmon të njëjtat që të përcjellën për leximin e dytë mbledhjes plenare. Kryesuesja e GP **Ganimete Musliu** për projektligjin e kompleksit “Adem Jashari” falënderoi komisionin për punën e frytshme lidhur me këtë

projektiligj, gjithashtu edhe **Andin Hoti** kryesues i GP për PL veprimtaritë hidrometeorologjike falënderoi për bashkëpunimin e frytshëm grupin punues rreth përfundimit të punës lidhur me këtë projektiligj.

- **Salih Salihu** i propozoi komisionit dy vizita në teren rreth dëmeve nga të reshurat (Rahovec dhe Institutin hidrometeorologjik) dhe një në Shqipëri lidhur me përvojat e tyre lidhur me dëmet në bujqësi.
- **Andin Hoti** propozoi të ftohet në komision ministri i MT lidhur me produktet bujqësore,
- **Enver Hoti** apeloj që diskutimet që u zhvilluan me ministrin e bujqësisë në mbledhjen e kaluar mos të mbesin vetëm në letër por të insistohet në përgjigjet të sakta dhe sidomos të dërgohet lista e përfituesve të grandeve, sa janë ato grande aktive etj. Projektiligjet që janë në agjendë të dërgohen sa më shpejt kurse komisioni të punoi me përkushtim dhe dinamikë të shtuar.
- **Kryetari** njoftoi se nga **Komisioni për legjislacion** është një kërkesë drejtuar këtij komisioni për inicimin e hartimit të ligjit për ndryshim e plotësim të ligjit të shitjes së banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, mirëpo ndërkohë pas komunikimit me zyrtarët kompetent të MMPH, të cilët kanë dhënë në dijeni se kjo ministri është në procedurën e hartimit të ligjit në fjalë, ndaj konstatoi se kjo pikë përmbillet me këtë njoftim, kurse falënderoi për pyetje dhe sugjerime të anëtarëve të komisionit dhe shtoi se ato do të diskutohen tani në pikën e radhës.

#### 4. Plani i punës së komisionit për vitin 2018

**Kryetari Muharrem Nitaj** duke u ndërlidhur me pikën paraprake në fillim konstatoi se në bazë të materialit të dërguar për këtë mbledhje ky komision radhitët në ato me suksese ngase 15% të punës me kryerjen e punëve legjislative ka përfunduar në këtë gjashtëmuor të këtij viti. Një projektiligj i cili përfundoi tani në mbledhjen plenare për trajtimin e ndërtimeve pa leje, vazhdoi ai, nuk do të ishte mirë të përsëritet jouniteti i komisionit sikurse që ndodhi me këtë projektiligj, ngase në komision ka përfunduar me punë të përbashkët kurse në mbledhje plenare ndodhën ndasitë, edhe pse mirëkuptohen qëndrimet politike të grupeve parlamentare. **Ganimete Musliu** u pajtua me këto konstatime ngase p.sh. kryesuesit të GP ju është ndaluar fjala gjatë mbledhjes plenare, gjithashtu ajo konstatoi se në komision duhet të gjitha çështjet të përfundojnë dhe jo të mbetet si në këtë rast që të shpalosen përçarjet në mbledhjen plenare, përkundër faktit që çdo deputet por edhe ajo ka drejtë të mbaj qëndrimin politik, ajo për tjera herë sugjeroi koordinim më të mirë në komision në mënyrë që mos të shfaqen këto skena të panevojshme rreth një projektiligji apo një çështjeje konkrete, dhe mos të shndërrohet në viktimë qytetari. **Lutfi Zharku** poashtu shprehu pajtimin rreth konstatimeve për shfaqjen e përçarjeve gjatë miratimit të projektiligjit të fundit të këtij komisioni, ngase siç tha ai, personalisht është deklaruar për mos angazhim në ndonjë GP vetëm për shkak që mos të bie ndesh me qëndrimet e tija personale e politike. **Salih Salihu** gjithashtu përkrahu përkushtimin për frymë të përbashkët gjatë punës së komisionit, fundja çdo sjellje e deputetit në kuvend ka koston e vet, tha ai dhe u fokusua në planin kombëtar në bujqësi i cili duhet të miratohet në Kuvend dhe në bazë të cilit do të formohet fondi i veçantë për dëme përkatësisht për grande dhe subvencione. Mos ardhja e projektiligjeve të planifikuara nga qeveria në kuvend dëmton mjaft por gjithashtu dëmton edhe fakti se në Kosovë prodhimi kryesor buka shitet me njësi pa u ditë sa peshon një bukë (ai tregoi disa analiza që janë kryer bashkërisht me studentë me ç'rast është konstatua se shumica e furrave prodhojnë bukën 400 gr. kurse duhet së paku të peshoj 600 gr.).

**Kryetari Muharrem Nitaj** me rastin e mbledhjes së parë me këtë komision premtoi që si kryetar i porsaemëruar do të angazhohet për mbrojtjen e çdo produkti të këtij komisioni në mbledhjet plenare gjithnjë mbi baza profesionale, ngase komisionet parlamentare përfaqësojnë hallkën më të rëndësishme të punës së kuvendit, ndaj pse një komision mos të gjej mbështetje në mbledhjen plenare. Në vazhdim ai kërkoi nga komisioni të diskutohet rreth projektiligjeve që do të mbërrijnë si duhet të veprohet në mënyrë që ato mos të punohen shkel e shko. **Salih Salihu** u përgjigj : ku me pas fatin ky komision të arrijnë ato në kuvend ngase puna me ekspert assesi nuk

do të mungoi, gjithashtu **Enver Hoti** reagoi në aspektin e arritjes së projektligjeve ngase puna e duhur nuk do të mungoi në këtë komision. **Ganimete Musliu** duke u pajtuar me parafolësit u angazhua rreth mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve ngase janë kapacitetet e mjaftueshme për të funksionuar edhe mbikëqyrja ma tepër përveç nxjerrjes së ligjeve, gjithashtu raportimet nga kuvendi të ndodhin më shumë dhe me rregull. **Kryetari** duke u ndërlidhur njoftoi se pikërisht sot qeveria ka mbledhjen e sajë ku do të vendoset për dëmet nga reshjet e fundit dhe ftoi deputetët e pranishëm që të fokusohen për caktimin e ditës kur mundet komisioni të vizitoi Rahovecin në bashkëpunim me deputetin nga ajo anë dhe stafin, duke sugjeruar ditën e fundit të kësaj jave, ndërkaq për vizitën në Shqipëri potencoi faktin se afër janë pushimet ndaj mirë do të ishte të lihet për shtator. **Ganimete Musliu** reagoi se vizita në Rahovec do të ishte e kotë nëse sot është mbledhja e qeverisë për dëmet, ngase komisioni do të kryej vizitën pa ndonjë efekt, gjithashtu edhe nëse dihet fakti se rishikim të buxhetit nuk do të ketë por më mirë do të ishte planifikim për vitin e ardhshëm. **Salih Salihu** kundërshtoi reagimin e Ganimete Musliut për shkak të shpërputhjes së vlerësimeve por fundi fundit siç tha ai nuk insiston për këtë vizitë. **Andin Hoti** gjithashtu arsyetoi vizitën në terren sepse vlerësimet e para kanë treguar 1.2 milion dëme kurse më vonë janë 4 milion dëme në kulturat bujqësore, kurse **Enver Hoti** propozoi një shtesë buxhetore për vitin e ardhshëm pasi që kemi të bëjmë me kultura sezonale dhe pasoja të vazhdueshme.

**Kryetari Muharrem Nitaj** në fund falënderoj dhe potencoi se ka mundësi që kjo mbledhje të jetë e fundit për këtë sesion pranveror, përshëndeti deri në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11,07.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

Kryetari i Komisionit,  
**Muharrem Nitaj**